



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË (HUAMARRËSI), OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE), SH.A., (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT) DHE KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E INVESTIMEVE PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE I”

I. HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a (agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main, (KfW), për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

II. QËLLIMI DHE PERMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Republikës së Gjermanisë nëpërmjet KfW-së për financimin e programit të investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike I.

Marrëveshja konsiston në akordimin e një fondi nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, nëpërmjet KfW-së në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milion) euro dhe një granti në vlerën 2 000 000 (dy milion) euro për masat e nevojshme shoqëruese të programit.

Kjo hua do të përdoret për financimin e projektit “Për programin e investimeve në shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Agjensia zbatuese e projektit do të jetë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a), e cila do të mbulojë nga buxheti i saj kostot për mbulimin e TVSH-së dhe kosto të tjera lokale në kuadër të projektit.

Marrëveshja synon që përmes marrjes të fondit të parashikuar të realizojë tre komponentë të programit :

- 1) Komponentin e parë mbi realizimin dhe krijimin e një sistemi kontrolli mbikëqyrës dhe të përpunimit të të dhënave (SCADA), krijimin e një sistemi menaxhimi të shpërndarjes (DMS), sistemi të shpërndarjes së ngarkesës (LDS), një qendër të kontrollit të shpërndarjes (DCC), dhe sisteme të tjera të integruara të teknologjisë së informacionit (IT).
- 2) Komponentin e dytë që do të përfshijë rehabilitimin dhe/ose ndërtimin e nënstacioneve të përzgjedhura, duke përfshirë kapacitetin e transmetimit në nënstacionet e mbingarkuara, si dhe zgjerimin e voltazhit të mesëm të nënstacioneve ekzistuese.
- 3) Komponentin e tretë do të përfshijë përshtatjen e rrjetit me voltazh të mesëm në nivelin 20 kV në zonat e përzgjedhura.

Në marrëveshje është parashikuar shuma e financimit, interesi, tarifa e angazhimit, tarifa e menaxhimit dhe maturimi.

Norma e interesit të huas nuk është përcaktuar në marrëveshje, por është dakordësuar në marrëveshje se kjo normë do të përcaktohet nga KfW-ja dy ditë pune nga marrja e njoftimit se janë përmbushur kushtet e bërjes efektive të marrëveshjes së huas.

Sa i takon pikëpamjes strategjike, programi për të cilin do të përdoren fondi dhe granti i parashikuar do të ndikojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe të sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët në Shqipëri.

III. DISKUTIMI NË KOMISION

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të përfaqësues të Ministrisë së Infstrukturës dhe Energjisë. Deputetët në komision u informuan rreth qëllimit të projektligjit dhe kushteve të parashikuara në marrëveshje. Përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se kjo marrëveshje do të bëjë të mundur për Republikën e Shqipërisë akordimin e një fondi nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, nëpërmjet KfW-së në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milion) euro dhe një granti në vlerën 2 000 000 (dy milion) euro për masat e nevojshme shoqëruese të programit të investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I. Deputetët pasi u informuan për kushtet specifike të marrëveshjes dhe normën e interesit të parashikuar, vlerësuan bashkëpunimin me KfW-në dhe ndikimin që pritet të ketë ky fond në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipëri.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATORE

KRYETARE

ELONA GJEBREA

MIMI KODHELI